



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III
Sesioni pranveror

Seancë plenare e Kuvendit
P- 031
Prishtinë, më 15 korrik 2008, në orën 10:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla e seancave plenare.

PROCESVERBAL

**I SEANCËS PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS, TË MBAJTUR MË
15 KORRIK 2008**

Seancën e kryesoi **Jakup Krasniqi**, Kryetar i Kuvendit, kurse i ndihmoi **Xhavit Haliti**, anëtar i Kryesisë.

Kryetari konstatoi se në seancë janë të pranishëm 75 deputetë dhe e deklaroi të hapur punën e saj.

Kryetari njoftoi deputetët se Kryesia e Kuvendit, në marrëveshje me grupet parlamentare, në pajtim me rregullat 6.2 dhe 23 të Rregullores së Punës së Kuvendit, ka përgatitur dhe Kuvendit ia ka paraqitur rendin e ditës për seancën e sotme plenare.

Ndërkohë, Kryetari me propozimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës kërkoi nga deputetët që të deklarohen për radhitjen e Propozim-vendimit për emërimin e anëtarëve të Bordit të Agjencisë Kosovare të Privatizimit si pikë e fundit të rendit të ditës.

Kryetari kërkoi nga shefat e grupeve parlamentare të deklarohen lidhur me propozimin e Qeverisë.

Ramë Buja, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së tha se mbështet propozimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës për emërimin e anëtarëve të Bordit të Agjencisë Kosovare të Privatizimit, që të radhitet si pikë e fundit të rendit të ditës.

Lutfi Haziri, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së tha se mbështet propozimin e Qeverisë për emërimin e anëtarëve të Bordit të Agjencisë Kosovare të Privatizimit, që të radhitet si pikë e fundit të rendit të ditës.

Ibrahim Makolli, në emër të Grupit parlamentar të AKR-së tha se mbështet propozimin e Qeverisë për emërimin e anëtarëve të Bordit të Agjencisë Kosovare të Privatizimit, që të radhitet si pikë e fundit të rendit të ditës, por kërkoi që të sqarohet kërkesa e Qeverisë për dy anëtarët që janë propozuar nga sindikatat në Bordin e Agjencisë Kosovare për Privatizim.

Ardian Gjini, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së tha se nuk e mbështet propozimin e Qeverisë, që të radhitet si pikë e fundit e rendit të ditës.

Adem Salihaj, në emër të Grupi Parlamentar të LDD-së tha se nuk e mbështet propozimin e Qeverisë, që të radhitet si pikë e fundit e rendit të ditës.

Zylfi Merxha, në emër të Grupi Parlamentar “7+” tha se nuk e mbështet propozimin e Qeverisë që të radhitet si pikë e fundit e rendit të ditës.

Sllobodan Petroviq, në emër të Grupi Parlamentar të SLS, tha se e mbështet propozimin e Qeverisë që të radhitet si pikë e fundit e rendit të ditës të seancës së sotme.

Kryetari e hodhi në votim propozimin e Qeverisë për emërimin e anëtarëve të Bordit të Agjencisë Kosovare të Privatizimit, që të radhitet si pikë e fundit të rendit të ditës të seancës së sotme. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----44;
Kundër-----12.
Abstenime-----5.

Kryetari konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash miratoi propozimin e Qeverisë për emërimin e anëtarëve të Bordit të Agjencisë Kosovare të Privatizimit, që të radhitet si pikë e fundit të rendit të ditës të seancës së sotme.

Pastaj, **Kryetari** njoftoi deputetët se ministrja e Drejtësisë **Nekibe Kelmendi** ka propozuar heqjen nga rendi i ditës të pikës së 7 - të - Shqyrtimi i Raportit me rekomandime të Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi për zgjedhjen e anëtarëve të Komisionit për dhënien e provimit të jurisprudencës

Kryetari kërkoi deklarimin e shefave të grupeve parlamentare lidhur me propozimin e ministres **Nekibe Kelmendi** për heqjen nga rendi i ditës të pikës së 7-të të seancës së sotme.

Lutfi Haziri, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së tha se e mbështet propozimin që pika e 7-të të tërhiqet nga rendi i ditës, me arsyetim të koordinimit më të mirë ndërmjet ministres së Drejtësisë dhe organeve të tjera që të funksionalizohet kjo pjesë e punës.

Bahri Hyseni, në emër të Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi e arsyetoi raportin e Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi për kandidatët e propozuar për anëtarë të Komisionin për dhënien e provimit të jurisprudencës.

Ramë Buja, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së tha se mbështet propozimin e ministres **Kelmendi** që pika e 7-të të hiqet nga rendi i ditës.

Ibrahim Makolli, në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së tha se nuk e mbështet propozimin që pika e 7-të të hiqet nga rendi i ditës.

Ardian Gjini, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së mbështeti propozimin që pika e 7-të të hiqet nga rendi i ditës.

Adem Salihaj, në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së deklaroi se mbështet propozimin që pika e 7-të të hiqet nga rendi i ditës.

Sadik Idriz, në emër të Grupit Parlamentar “7+” deklaroi se mbështet propozimin që pika e 7-të të tërhiqet nga rendi i ditës.

Bojan Stojanoviq, në emër të Grupit Parlamentar të SLS-së mbështeti propozimin që pika e 7-të të tërhiqet nga rendi i ditës.

Kryetari e hodhi në votim propozimin e ministres **Kelmendi** që pika e 7-të të tërhiqet nga rendi i ditës. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për----- shumica,
Kundër-----8,
Abstenime-----2.

Kryetari konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash miratoi propozimin e ministres **Kelmendi** që pika e 7-të të tërhiqet nga rendi i ditës për seancën e sotme.

Deputeti **Driton Tali** propozoi që në rend dite të seancës së sotme të përfshihet edhe një pikë shtesë, që Kuvendi të diskutojë dhe të marrë qëndrim lidhur me letrën e Sekretarit të OKB-së, zotit Ban Ki Mun. Ky propozim nuk u miratua me arsyetim se kjo çështje është precizuar me Kushtetutë, të miratuar nga ky Kuvend, dhe se kërkohet nga të gjitha organet përgjegjëse që atë ta zbatojnë në tërë territorin e Republikës së Kosovës.

Po ashtu, **Kryetari** njoftoi deputetët se me pëlqimin e kryetarëve të grupeve parlamentare është vendosur që nga rendi i ditës të hiqet: - Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për sigurinë private.

Kryetari e hodhi në votim propozimin që nga rendi i ditës të hiqet - Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për sigurinë private.

Kryetari konstatoi se Kuvendi, me shumicë absolute të votave, hoqi nga rendi i ditës - Shqyrtimin e dytë të Projektligjit për sigurinë private.

Pastaj, Kuvendi i zhvilloi punimet me këtë

R e n d d i t e:

1. Miratimi i procesverbalit të seancës plenare të mbajtur më 30 qershor 2008,
2. Koha për pyetje parlamentare,
3. Shqyrtimi i Rekomandimit të Komisionit për Shërbime Publike, Administratë Lokale dhe Media lidhur me kërkesën e Qeverisë për tërheqjen nga procedura e shqyrtimit të Projektligjit për statistikë zyrtare të Republikës së Kosovës,
4. Shqyrtimi i Rekomandimit të Komisionit për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale lidhur me kërkesën e Qeverisë për tërheqjen nga procedura e shqyrtimit të Projektligjit për punën,

5. Shqyrtimi i Rekomandimit të Komisionit për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale lidhur me kërkesën e Qeverisë për tërheqjen nga procedura e shpalljes të Ligjit për sigurimin shëndetësor,
6. Shqyrtimi i Propozim-vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës për emërimin e anëtarëve të Bordit të Agjencisë Kosovare të Privatizimit.

1. Miratimi i procesverbalit të seancës plenare, të mbajtur më 30 qershor 2008

Procesverbali i seancës plenare të mbajtur më 30 qershor 2008, u miratua pa vërejtje.

2. Koha për pyetje parlamentare

Deputetja **Suzan Novobrdaliu** i parashtoi pyetje Kryeministrit **Hashim Thaçi** lidhur me rritjen e numrit të vetëvrasjeve, duke i përfshirë këtu edhe të rinjtë.

Ministrja e Drejtësisë **Nekibe Kelmendi** iu përgjigj pyetjes së deputetes **Novobrdaliu**.

Deputetja **Suzan Novobrdaliu** i parashtoi pyetje Kryeministrit **Hashim Thaçi** lidhur me rritjen e përqindjes së të papunëve në Kosovë, duke i përfshirë edhe qytetarët e moshës mbi 45 deri në 65 vjet, personat që më herët kanë punuar dhe kanë mbetur pa punë për shkak të privatizimit të ndërmarrjeve.

Ministri i Ekonomisë dhe i Financave **Ahmet Shala** iu përgjigj pyetjes së deputetes **Novobrdaliu**.

Deputetja **Gjylnaze Syla** i parashtoi pyetje Kryeministrit **Hashim Thaçi** lidhur me veprimet që i ka ndërmarrë Qeveria për të siguruar njohjen edhe të 60 shtete të tjera që ende nuk e kanë njohur Kosovën në mënyrë që të aplikojë për anëtarësim në OKB.

Kryeministri **Hashim Thaçi** iu përgjigj pyetjes së deputetes **Syla**.

Deputetja **Gjylnaze Syla** i parashtoi pyetje Kryeministrit **Hashim Thaçi** lidhur me qëndrimin e Qeverisë për rolin e UNMIK-ut dhe çfarë ka bërë Qeveria që të sigurojë zbatimin e dispozitave të përcaktuara në Kushtetutën e Republikës së Kosovës për UNMIK-un.

Kryeministri **Hashim Thaçi** iu përgjigj pyetjes së deputetes **Syla**.

Deputeti **Driton Tali** i parashtoi pyetje Kryeministrit **Hashim Thaçi** lidhur me involvimin e ministrit të Ekonomisë dhe të Financave, **Ahmet Shala**, në privatizimin e Feronikelit gjatë kohës sa ishte zëvendësudrejtor i AKM-së.

Kryeministri **Hashim Thaçi** iu përgjigj pyetjes së deputetit **Tali**.

Deputetja **Donika Kadaj-Bujupi** i parashtoi pyetje Kryeministrit **Hashim Thaçi** lidhur me krijimin e lehtësirave dhe të mundësive më të mira të pajisjes me dokumente dhe kërkesa të tjera të bashkatdhetarëve tanë gjatë qëndrimit në Kosovë.

Kryeministri **Hashim Thaçi** iu përgjigj pyetjes së deputetes **Kadaj-Bujupi**.

Deputetja **Synavere Rysha** i parashtoi pyetje Kryeministrit **Hashim Thaçi** lidhur me punëtorët arsimorë që kanë mbetur pa paga për arsye se kanë marrë pjesë si kandidat në zgjedhje.

Zëvendës kryeministri **Hajredin Kuçi** iu përgjigj pyetjes së deputetes **Rysa**.

Deputeti **Riza Smaka** i parashtoi pyetje Kryeministrit **Hashim Thaçi** lidhur me cenimin e sovranitetit dhe të integritetit territorial të Republikës së Kosovës.

Kryeministri **Hashim Thaçi** iu përgjigj pyetjes së deputetit **Smaka**.

Deputeti **Riza Smaka** i parashtoi pyetje Kryeministrit **Hashim Thaçi** lidhur me rritjen e çmimeve të artikujve jetësorë elementarë.

Ministri **Ahmet Shala** iu përgjigj pyetjes së deputetit **Smaka**.

Deputetja **Donika Kadaj-Bujupi** i parashtoi pyetje ministrit të Punëve të Jashtme **Skender Hyseni** lidhur me përfshirjen e bashkatdhetarëve tanë në procesin e lobimit.

Ministri **Skender Hyseni** iu përgjigj pyetjes së deputetes **Kadaj-Bujupi**.

Deputeti **Driton Tali** i parashtoi pyetje ministrit të Transportit dhe të Post-Telekomunikacionit **Fatmir Limaj** lidhur me investimet e Qeverisë në infrastrukturën rrugore në rajonin e Gollakut.

Ministri **Fatmir Limaj** iu përgjigj pyetjes së deputetit **Tali**.

Deputetja **Luljeta Shehu** i parashtoi pyetje ministres së Energjetikës dhe të Minierave **Justina Pula** lidhur me mundësinë e shlyerjes së borxhit për rrymë elektrike për familjet e të pagjeturve, të dëshmorëve dhe për familjet me asistencë sociale prej vitit 1999 deri në vitin 2007.

Ministrja **Justina Pula** iu përgjigj pyetjes së deputetes **Shehu**.

Deputetja **Luljeta Shehu** i parashtoi pyetje ministrit të Arsimit, të Shkencës dhe të Teknologjisë **Enver Hoxhaj** lidhur me rritjen e pagave të punëtorëve të arsimit në Kosovë.

Ministri **Enver Hoxhaj** iu përgjigj pyetjes së deputetes **Shehu**.

Deputeti **Rasim Selmanaj** i parashtoi pyetje ministrit të Administrimit të Pushtetit Lokal **Sadri Ferati** lidhur me funksionimin e pilot komunës së Junikut.

Ministri **Sadri Ferati** iu përgjigj pyetjes së deputetit **Selmanaj**.

Deputeti **Arsim Rexhepi** i parashtoi pyetje ministrit të Ekonomisë dhe të Financave **Ahmet Shala** lidhur me privatizimin e fabrikës së Llamkosit në Vushtri.

Ministri **Ahmet Shala** iu përgjigj pyetjes së deputetit **Rexhepi**.

Deputeti **Arsim Rexhepi** i parashtoi pyetje ministrit të Transportit dhe të Post-Telekomunikacionit **Fatmir Limaj** lidhur me pagesën e obligueshme prej 50 eurosh për sigurimin e automjeteve për mërgimtarët.

Ministri **Fatmir Limaj** iu përgjigj pyetjes së deputetit **Rexhepi**.

Deputeti **Arsim Rexhepi** i parashtoi pyetje ministrit të Ekonomisë dhe të Financave **Ahmet Shala** lidhur me privatizimin e fabrikës së “Vushteks”-it në Vushtri.

Ministri **Ahmet Shala** iu përgjigj pyetjes së deputetit **Rexhepi**.

Deputeti **Driton Tali** i parashtoi pyetje ministrit të Ekonomisë dhe të Financave **Ahmet Shala** lidhur me veprimet e ndërmarra të Qeverisë për pengimin e kontrabandës që zhvillohet në Veri të Kosovës me derivatet e naftës.

Ministri **Ahmet Shala** iu përgjigj pyetjes së deputetit **Tali**.

Deputeti **Armend Zemaj** i parashtoi pyetje ministrit të Arsimit **Enver Hoxhaj** lidhur me rritjen e numrit të studentëve që do të regjistrohen në Universitetin e Prishtinës në vitin 2008.

Ministri **Enver Hoxhaj** iu përgjigj pyetjes së deputetit **Zemaj**.

Deputeti **Agim Veliu** i parashtoi pyetje ministrit të Arsimit **Enver Hoxhaj** lidhur me zvogëlimin e kritereve (poenëve) për provimin e maturës.

Ministri **Enver Hoxhaj** iu përgjigj pyetjes së deputetit **Veliu**.

Deputetja **Myrvete Pantina** i parashtoi pyetje ministrit **Ahmet Shala** lidhur me privatizimin e fabrikës së “Llamkos”-it në Vushtri.

Ministri **Ahmet Shala** iu përgjigj pyetjes së deputetes **Pantina**.

Deputetja **Suzan Novobrdaliu** i parashtoi pyetje ministres së Energjetikës dhe të Minierave **Justina Pula** lidhur me reduktimet e energjisë elektrike.

Ministrja **Justina Pula** iu përgjigj pyetjes së deputetes **Novobrdaliu**.

3. Shqyrtimi i Rekomandimit të Komisionit për Shërbime Publike, Administratë Lokale dhe Media lidhur me kërkesën e Qeverisë për tërheqjen nga procedura e shqyrtimit të Projektligjit për statistikën zyrtare të Republikës së Kosovës

Kryetari i njoftoi deputetët se Kuvendi këtë projektligj e ka miratuar, në parim, më 2 qershor 2008 dhe e ka ngarkuar Komisionin për Shërbime Publike, Administratë Lokale dhe Media, si komision funksional, si dhe komisionet kryesore që brenda dy muajve ta shqyrtojnë projektligjin dhe Kuvendit t’ia paraqesin raportet me rekomandime.

Kryetari i informoi deputetët se Qeveria ka kërkuar që Projektligji të tërhiqet nga procedura e shqyrtimit dhe se Kryesia e Kuvendit dhe Komisioni funksional për Shërbime Publike, Administratë Lokale dhe Media e kanë shqyrtuar dhe përkrahur kërkesën e Qeverisë.

Kryetari e hodhi në votim Rekomandimin e komisionit funksional. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për----- 58;

Kundër----- 1.

Abstenime-----6.

Kryetari konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash, mori këtë

V E N D I M

Projektligji për statistikat zyrtare i kthehet për ripunim propozuesit – Qeverisë së Kosovës.

4. Shqyrtimi i Rekomandimit të Komisionit për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale lidhur me kërkesën e Qeverisë për tërheqjen nga procedura e shqyrtimit të Projektligjit për punën

Kryetari i njoftoi deputetët se Kuvendi këtë projektligj e ka miratuar, në parim, më 2 qershor 2008 dhe e ka ngarkuar Komisionin për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, si komision funksional, dhe komisionet kryesore që ta shqyrtojnë projektligjin dhe Kuvendit t’ia paraqesin raportet me rekomandime brenda dy muajve.

Kryetari i informoi deputetët se Qeveria ka kërkuar që Projektligji të tërhiqet nga procedura e shqyrtimit dhe se Kryesia e Kuvendit dhe Komisioni funksional për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale e kanë shqyrtuar dhe përkrahur kërkesën e Qeverisë.

Kryetari e hodhi në votim Rekomandimin e komisionit funksional. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për----- 65;
Kundër----- 0.
Abstenime-----7.

Kryetari konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash, mori këtë

V E N D I M

Projektligji për punë tërhiqet nga procedura e shqyrtimit dhe i kthehet për ripunim propozuesit – Qeverisë së Kosovës.

5. Shqyrtimi i Rekomandimit të Komisionit për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale lidhur me kërkesën e Qeverisë për tërheqjen nga procedura e shpalljes të Ligjit për sigurimin shëndetësor

Kryetari i njoftoi deputetët se miratimi i këtij ligji është bërë më 22 shkurt 2007, por nuk është shpallur nga PSSP-ja.

Kryetari i informoi deputetët se Qeveria ka kërkuar që Ligji të tërhiqet nga procedura e shpalljes dhe se Kryesia e Kuvendit dhe Komisioni funksional për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale e kanë shqyrtuar dhe përkrahur kërkesën e Qeverisë.

Kryetari e hodhi në votim Rekomandimin e komisionit funksional. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për----- 65;
Kundër----- 1.
Abstenime-----8.

Kryetari konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash, mori këtë

V E N D I M

Ligji për sigurimet shëndetësore tërhiqet nga procedura e shpalljes dhe i kthehet për ripunim propozuesit – Qeverisë së Kosovës.

6. Shqyrtimi i Propozim-vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës për emërimin e anëtarëve të Bordit të Agjencisë Kosovare të Privatizimit

Kryetari i njoftoi deputetët se në pajtim me Ligjin për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, Qeveria ka parashtruar për shqyrtim dhe miratim në Kuvend Propozim-vendimin për emërimin e anëtarëve të Bordit të Agjencisë Kosovare të Privatizimit. Në pajtim me nenin 12, paragrafi 2 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, Kuvendi i Kosovës do të emërojë 5 drejtorë, duke përfshirë 1 përfaqësues nga një komunitet joshqiptar si dhe kryetarin e Bashkimit të Sindikatave të Pavarura të Kosovës dhe do të përcaktojë njërin nga të emëruarit që të shërbejë si kryetar i Bordit.

Kryetari ftoi ministrin **Ahmet Shala**, që në emër të Qeverisë së Republikës së Kosovës para deputetëve të arsyetojë Propozim-vendimin për emërimin e anëtarëve të Bordit të Agjencisë Kosovare të Privatizimit si dhe të propozojë njërin prej anëtarëve për kryesues të Bordit.

Ministri i Ekonomisë dhe Financave, **Ahmet Shala**, në emër të Qeverisë arsyetoi Propozim-vendimin për emërimin e anëtarëve të Bordit të Agjencisë Kosovare të Privatizimit.

Anëtarët e propozuar nga ana e Qeverisë, 4 prej të cilëve kanë shërbyer deri më tani si anëtarë të (ish) Agjensionit Kosovar të Mirëbesimit, janë: Dino Hasanaj, i propozuar kryesues i Bordit, Fadil Ferati, Haxhi Arifi, përfaqësues i BSPK, Sllobodan Petroviq, dhe Bahri Shabani. CV-të e të gjithë këtyre anëtarëve janë të bashkëngjitura me material dhe kërkoj nga deputetët që të miratohen këta kandidatë për anëtarë të Bordit të Agjensionit Kosovar të Privatizimit në mënyrë që ky institucion të vazhdojë të funksionojë konform ligjit.

Kryetari, pas arsyetimit të Propozim-vendimit për emërimin e anëtarëve të Bordit të Agjencisë Kosovare të Privatizimit kërkoi nga kryetarët e grupeve parlamentare që të deklarohen lidhur me Propozim-vendimin e Qeverisë.

Ramë Buja, kërkoi që të sqarohet kërkesa e Qeverisë për dy anëtarët që janë propozuar nga Sindikata në Bordin e Agjencisë Kosovare për Privatizim, përkatësisht për propozimin e Bahri Shabanit për anëtar të Bordit.

Ministri **Ahmet Shala** e arsyetoi propozimin e **Bahri Shabanit** për anëtar të Bordit duke theksuar se zoti **Shabani** ishte konsideruar si përfaqësues i ekspertëve.

Ramë Buja, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së tha se mbështet propozimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës për emërimin e anëtarëve të Bordit të Agjencisë Kosovare të Privatizimit.

Lutfi Haziri, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së tha se mbështet propozimin e Qeverisë për emërimin e anëtarëve të Bordit të Agjencisë Kosovare të Privatizimit.

Ibrahim Makolli, në emër të Grupit parlamentar të AKR-së tha se nuk e mbështet propozimin e Qeverisë për emërimin e anëtarëve të Bordit të Agjencisë Kosovare të Privatizimit.

Ardian Gjini, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së tha se nuk e mbështet propozimin e Qeverisë për emërimin e anëtarëve të Bordit të Agjencisë Kosovare të Privatizimit.

Berim Ramosaj, në emër të Grupi Parlamentar të LDD-së deklaroi se nuk e mbështet tërësisht propozimin e Qeverisë për emërimin e anëtarëve të Bordit të Agjencisë Kosovare të Privatizimit.

Sadik Idriz, në emër të Grupi Parlamentar “7+” deklaroi se e mbështet propozimin e Qeverisë për emërimin e anëtarëve të Bordit të Agjencisë Kosovare të Privatizimit.

Bojan Stojanoviq, në emër të Grupi Parlamentar të SLS-së tha se e mbështet propozimin e Qeverisë për emërimin e anëtarëve të Bordit të Agjencisë Kosovare të Privatizimit.

Ministri **Ahmet Shala** e lexoi deklaratën e kandidatit për anëtar të Bordit **Bahri Shabani** në të cilën z. **Shabani** kishte deklaruar se nëse miratohet propozimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës për emërimin e tij për anëtar të Bordit të Agjencisë Kosovare të Privatizimit për të kryer këtë detyrë, do t'i pushojë të gjitha aktivitetet në Konfederatën e Sindikatave të Lira të Kosovës.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me propozimin e Qeverisë për emërimin e anëtarëve të Bordit të Agjencisë Kosovare të Privatizimit dhanë: **Naim Maloku, Riza Smaka, Driton Tali, Gjylnaze Syla, Vezira Emrush** dhe **Sabri Hamiti**, të cilat janë dhënë në transkript.

Kryetari e hodhi në votim propozimin e Qeverisë për emërimin e anëtarëve të Bordit të Agjencisë Kosovare të Privatizimit. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për----- 40;
Kundër----- 22.
Abstenime-----8.

Kryetari konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash, mori

V E N D I M

Për emërimin e anëtarëve të Bordit të Agjencisë Kosovare të Privatizimit

I. Anëtarë të Bordit të Agjencisë Kosovare të Privatizimit emërohen:

1. Dino Hasanaj, kryesues,
2. Fadil Ferataj,
3. Haxhi Arifi,
4. Slllobodan Petroviq, dhe
5. Bahri Shabani

Kryetari e deklaroi të mbyllur seancën në orën 17:10 minuta.

Kryetari i Kuvendit
Jakup KRASNIQI

Përgatiti:

Divizioni i Çështjeve Plenare dhe Procedurale